

VENDIM
Nr. 161, datë 2.3.2016

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore, si më poshtë vijon:
 - a) Numri i punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes shtohet me 9 veta, për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, duke e çuar numrin total të punonjësve të ministrisë në 595 veta;
 - b) Numri i punonjësve të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit reduktohet me 9 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Kulturës në 1005 veta.
 2. Kalimi i punonjësve nga Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit tek Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut kryhet pas miratimit të strukturës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe institucionet e përmendura më sipër për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama